



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:086052

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05449946

**C.nr.1126/23**

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – **Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni civil** me gjyqtarin Agron Karatash , me zyrtaren ligjore Imihane Ramadani në çështjen juridiko- kontestimore të paditësit F.G., të cilën e përfaqësojnë Av. B.K., nga Prizreni, kundër të paditurit Komuna e Prizrenit/Drejtoria Komunale e Arsimit rr. “Remzi Ademaj” p.nr. Prizren , për kompenzimin e shujtave ditore për vitin 2021, me datë 14.03.2024, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

### **-Pa shqyrtim kryesor të çështjes-**

**I. APROVOHET** kërkesëpadia e F.G., nga Prizreni.  
**DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit/Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, që paditësit të i kompensoj në emër të shujtave ditore nga 2 euro për secilën ditë të punës për vitin 2022 dhe atë për;

- **F.G.**, në emër të shujtave ditore për vitin 2022 për 144 ditë pune (për periudhën prej 01.01.2022deri më 15.11.2022) t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 288.00 (dyqind e tetëdhjetë e tetë) euro; të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, që nga nga data e parashtrimit të padisë prej 07.04.2023 deri në realizimin e pagesës definitive, të gjitha këto brena 7 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.

**II.** Shpenzimet e procedurës bien në barrë të paditurës në shumë prej 104.00 euro për përpilimin e padisë dhe 20 euro për taksën gjyqësore e cila duhet të paguhet 7 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.

## **A r s y e t i m**

Paditësi, përmes të autorizuarve të tij, pranë kësaj gjykate me datën 07.04.2023, kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, me objekt kontesti kompensimin e shujtave për vitin 2022.

I autorizuari i paditësit në padi kanë theksuar se paditësit ju takon kompensimi për shujtat ditore për vitin 2022, nga 2 euro në ditë për çdo ditë pune, sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësve vullnetarisht, kanë propozuar gjykatës që të merr aktgjykim dhe ta aprovoj kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore i kanë kërkuar.

E paditura, përmes përfaqësueses ligjore të komunës, në përgjigjen në padi të datës 06.07.2023 e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, lidhur me kompensimin e shujtës ditore. Është theksuar se bazuar në njoftimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me numër 01B/488, të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021, padia dhe kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar. Po ashtu sipas të autorizuarit të të paditurës përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësit nuk kanë ofruar ndonjë provë që janë anëtarë të sindikatës.

Po ashtu ka theksuar se të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-193. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditësve është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e saj. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Paditësi padisë ia ka bashkangjitur provat materiale si në vijim: vërtetimin e pranisë në punë të lëshuar nga i padituri nr. Ref.90/23 të datës 26.01.2023, për vitin 2022.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi janë në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në SH.F.M.U.“Avdyl Frashëri” Komuna Prizren.

Nga vërtetimi i lëshuar me numër reference 90/23, të datës 26.01.2023, nga drejtori i shkollës SH.F.M.U.“Avdyl Frashëri” Komuna Prizren, gjykata vërtetoi faktin se paditësi paditësi, pranë kësaj shkolle në vitin 2022, ka punuar gjithsej 144 ditë pune.

Vërtetimin e lartcekur, gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, pasi vërtetimet janë lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat si të tillë janë të pranueshëm edhe për vetë palën e paditur.

Në bazë të fakteve të kësaj çështjeje, gjykata ka gjetur se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me numër 01/B, numër të prot. 105, e

datës 22.01.2021, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Me nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, është përcaktua e drejta e punëtorëve në kompensimin e shujtave dhe atë “Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë dhe vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune në institucionet arsimore...”.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: “Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”, pasi që e paditura ka pasur për detyrim që paditësin si punëtor i arsimit-mësimdhënës, t’ia paguaj kompensimin e shujtave, konform detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, neni 35 paragrafi 7, pasi që për paditësit, kërkesa është bërë e arritshme për nga 185 ditë pune, përkatësisht për vitin 2020 kanë punuar nga 185 ditë pune, apo shuma e përgjithshme nga 370.00 euro për secilin.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (08.02.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike.

Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor. Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi

Andaj gjykata duke u bazuar në Nenin 152 të Ligjit të Procedurës Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK), vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata obligon të Paditurin që të paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore në përputhje me Nenin 452 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**

2023:086052, 14.03.2024

**G j y q t a r i**

**Agron Karatash**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimin të njëjtit, drejtuar Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.